

Një *vështrim* mbi
**Treguesit e Zhvillimit
Ekonomik të
Shqipërisë (2022)**

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Prill 2023





Ky publikim është një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri të publikuara nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky dokument nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve.

▼ PËRMBAJTJA

- ▼ Llogaritë Kombëtare
 - ▼ Tregtia e Jashtme
 - ▼ Tregu i Punës
 - ▼ Investimet
 - ▼ Tregues Monetar
 - ▼ Renditja e Shqipërisë sipas:
 - Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit**
 - Indeksi i Lirisë ekonomike**
 - Indeksi Global i Inovacionit**

Një *vështrim* mbi
Treguesit e Zhvillimit
Ekonomik të Shqipërisë

ECURIA E TREGUESVE KRYESORE MAKROEKONOMIKË



4.84%
RRITJA VJETORE



6.7%
INFLACIONI



11%
PAPUNËSIA

Përgjatë vitit 2022, **ekonomia u rrit me 4,84%** krahasuar me vitin e kaluar


Inflacioni u rrit mbi objektivin e Bankës së Shqipërisë prej 3%, duke regjistruar **vlerë mesatare vjetore prej 6,7%**. Vlera më e lartë u shënua gjatë muajit tetor 2022, me 8,3%.

Flukset e IHD-ve gjatë vitit 2022 u rritën me 32,6% krahasuar me vitin 2021, ndërsa stoku i IHD-ve u rrit me 18,8%. Hollanda vazhdon të jetë lider në flukset hyrëse të IHD-ve me 219 milionë Euro. Investime në pasuritë e patundshme ishin aktiviteti më tërheqës për IHD-të gjatë vitit 2022. Fitimi i riinvestuar në 2022 përbënte 53% të totalit të IHD.

Në 2022, norma zyrtare e papunësisë rregjistroi shifrën **11%** me rrënie 0,5 p.p krahasuar me një vit më parë.

ECURIA E RRITJES EKONOMIKE


Rritja Ekonomike, Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor



Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë e nisur nga viti 2015, u ngadalësua përgjatë vitit 2019 dhe ra përgjatë vitit 2020 me -3,3%, rënie më e vogël krahasuar me parashikimet fillestare, si rezultat i pandemisë COVID19. Gjatë 2022 rritja vlerësohet 4,84% bazuar në vlerësimet paraprake të INSTAT, rritje mbi pritshmëritë.

Burimi: BB, Zyrtat Statistikore të vendeve


RER, Banka Botërore vjeshtë 2022



Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë përgjatë vitit 2022, vlerësohet të jetë e treta në rajon pas Malit të Zi, dhe Bosnjë Hercegovonës dhe në nivele të njëjta me Serbinë. Parashikimet e BB tregojnë se gjatë vitit 2023 dhe vitit 2024 rritmet e rritjes ekonomike në rajon do të ngadalësohen.

ECURIA E RRITJES EKONOMIKE

Rritja ekonomike Shqipëria 2022




Bazuar në të dhënat
paraprake, Produkti i
Brendshëm Bruto gjatë
vitit 2022 në Shqipëri u
rrit me 4,8%.
Kjo rritje është dukshëm
mbi parashikimet e
institucioneve kombëtare
dhe ndërkombëtare.

Burimi: INSTAT, Mars 2023, MFE, BB, BERZH

RRITJA EKONOMIKE SIPAS TREMUJORËVE

Rritja Vjetore, Sipas Tremujorëve në %



Burimi: INSTAT, Mars 2023

PBB, bazuar në të dhënat e publikuara nga INSTAT, në TIV2022 vazhdoi rritjen pozitive të nisur nga TI2021 me ritme më të larta (4,73%, kundrejt TIV2021).

Kontribut pozitiv kanë dhënë degët:

Ndërtimi +1,69p.p,
Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor +0,96p.p,
Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia +0,88 p.p,
Industri, Energji dhe Uji +0,70 p.p,
Aktivitete të pasurive të paluajtshme +0,54 p.p,
Informacioni dhe Komunikacioni +0,47 p.p,
Aktivitete Financiare dhe të Sigurimit +0,26p.p.

Negativisht kontribuan aktivitetet:

Arte, argëtim dhe çlodhje; aktivitete të tjera shërbimi -0,42p.p,
Bujqësi, Pyje dhe Peshkim -0,12p.p,
Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative -0,09p.p.


E ARDHURA PËR FRYMË

Produkti i Brendshëm Bruto për frymë (USD/frymë)




Burimi: World Development Indicators, Mars 2023

Për vitin 2021, e ardhura për frymë e Shqipërisë vlerësohet **6.493 USD** në vlerë korrente, më lart se një vit më parë.



QARKULLIMI I MALLRAVE NË TREGTINË E JASHTME

Tregtia e jashtme, miliardë lekë



Burimi: INSTAT, Mars 2023


Në vitin 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën **487 mld lekë, duke u rritur me 32%**, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 950 mld lekë, duke u rritur me 17%, krahasuar me një vit më parë.

Deficiti tregtar arriti vlerën 463 mld lekë, duke rënë me **7,3%**, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

Përqindja e mbulimit të eksporteve ndaj importeve u rrit në **51,3%**

QARKULLIMI I MALLRAVE NË TREGTINË E JASHTME

Importe në vite, milionë lekë




Importet gjatë vitit 2022, janë rritur në të gjithë grup-mallrat duke kaluar edhe nivelet e vitit 2020.

Rritja më e madhe vihet re në grupin Minerale, Lëndë Djegëse dhe Energji elektrike.

Burimi: INSTAT, Mars 2023

QARKULLIMI I MALLRAVE NË TREGTINË E JASHTME

Eksporte në vite, në milionë lekë




Grupmallrat me rritjen më të lartë përgjatë vitit 2022 janë Produkte kimike dhe plastike, të ndjekur nga Minerale, lëndë ndjekëse, energji elektrike.

Burimi: INSTAT, Mars 2023

IMPORTET E MALLRAVE

Importet sipas produkteve




Struktura e importeve të mallrave gjatë 2022 dominohet nga minerale, lëndë djegëse, energji elektrike, në dallim nga vitet e tjera.

- Ushqime, pije, duhan
- Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike
- Produkte kimike dhe plastike
- Lëkurë dhe artikuj prej lëkure
- Prodhime druri dhe letre
- Tekstile dhe këpucë
- Materiale ndërtimi dhe minerale

Burimi: INSTAT, Mars 2023

EKSPORTET E MALLRAVE

Eksporte sipas produkteve



Eksportet sipas produkteve vazhdojnë të ruajnë strukturën e tyre të njëjtë me vitin e kaluar.

Ndërkohë, në vështrim të ecursisë nga 2015 - 2022, vihet re konsolidim i uljes së përqindjes ndaj totalit të eksporteve të grupit “Tekstile dhe këpucë” dhe Minerale, lëndë, djegëse” dhe një rritje të eksporteve në “Materiale ndërtimi dhe minerale”.


- Ushqime, pije, duhan
- Produkte kimike dhe plastike
- Prodhime druri dhe letre
- Materiale ndërtimi dhe minerale
- Të tjera
- Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike
- Lëkurë dhe artikuj prej lëkure
- Tekstile dhe këpucë
- Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi

Burimi: INSTAT, Mars 2023

QARKULLIMI I MALLRAVE

-sipas vendeve partnere

Eksporte, vendet kryesore, në milionë lekë



Burimi: INSTAT, Mars 2023

Shkëmbimet tregtare, në vitin 2022, me vendet e BE-së zënë **59,0%** të gjithë tregtisë.

Në periudhën Janar – Dhjetor 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë **73,4%** të eksporteve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë:


Italia **(29,0%)**,
Turqia **(8,4%)**,
Greqia **(6,9%)**
Gjermania **(6,3%)**.

Në 2022 vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Itali **(35,1%)**, Kosovë **(0,2%)** dhe Gjermani **(58,6%)**. Ndërsa vendi me të cilin eksportet kanë pasur uljen më të madhe, është: Spanja **(0,9%)**.

QARKULLIMI I MALLRAVE

-sipas vendeve partnere

Importe, vendet kryesore partnere, në milionë lekë



Burimi: INSTAT, Mars 2023

Në periudhën Janar – Dhjetor 2022, importet nga vendet e BE-së zënë **51,6%** të importeve gjithsej.

Në 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë:

Italia **(5,9%),**

Turqia **(33,1%)**

Kina **(18,8%).**

Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë:


SHBA **(10,3%),**

Rusia **(27,3%)**

Austria **(1,1%).**

EKSPORTET NË SHËRBIME KONTEKSTI RAJONAL


Eksportet ne sherbime ICT, Ballkani Perendimor në million USD



Edhe gjatë vitit 2021, Shqipëria vazhdon të renditet e dyta në rajon përsa u përket eksportit të shërbimeve. Serbia është e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor përsa i përket eksportit të shërbimeve.

Burimi: World Development Indicators, Mars 2023


Eksportet në shërbime, Ballkani Perëndimor në milion USD



Ndërkohë Shqipëria renditet e fundit në rajon përsa i përket eksportit në Shërbime ICT.

INDEKSI I ÇMIMIT TË KONSUMIT

Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor %




Burimi: INSTAT, Mars 2023

Rritja mesatare vjetore e çmimeve në vitin 2022 është 6,7% nga 2,0% që ishte në vitin 2021

Bazuar edhe në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3%, por tendeca rritëse janë vënë re duke filluar nga muaji Nëntor 2021, ku Inflacioni i regjistruar tejkaloi objektivin e BSH dhe arriti kulmin në muajin Tetor 2022, me 8,3%.

KURSI I KËMBIMIT

Ecuria e kursit të këmbimit, USD/ALL, EURO/ALL




Përgjatë vitit 2022, kursi mesatar i këmbimit Lekë/Euro ishte 118,98 ndërsa Lekë/USD ishte 113,04;

Burimi: BSH, Mars 2023


KREDIA PËR EKONOMINË

Kredia e re per ekonomine, në milionë lekë



Burimi: BSH, Mars 2023


Kredia për ekonominë, në milionë lekë



Kredia totale për ekonominë arriti në 713,5 miliardë lekë në dhjetor 2022 ndërsa shumica e kredisë së re gjatë vitit 2022 shkoi në tregtinë me shumicë dhe pakicë, Ndërtimi dhe Industria.

FORCA E PUNËS


Norma e papunësisë



Gjatë vitit 2022, bazuar në të dhëna paraprake shkalla e papunësisë u ul me 0,5 p.p krahasuar me një vit më parë.

PAGA MESATARE SIPAS SEKTORËVE (në Lekë)

Paga mesatare mujore bruto sipas aktiviteteve kryesore




Gjatë TIV 2022, pagat më të larta janë regjistruar në sektorin e “Aktiviteteve financiare dhe sigurimit”, pasuar nga “Informacioni dhe Komunikimi”.

Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin “Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim”.

Gjatë 2021 paga mesatare ka pësuar rritje në të gjithë sektorët dhe rritja më e madhe vërehet në Tregti, Industri Nxjerrëse, IT, Administrata publike dhe Bujqësia

PAGA MESATARE DHE PAGA MINIMALE

Paga bruto në lekë



Paga mesatare gjatë 2022 (të dhëna paraprake) është raportuar në 61.884 lekë me rritje 8,2% kundrejt një viti më parë.


Paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin privat ishte 58.194 lekë me një rritje 12,3% krahasuar me një vit më parë; Ndërkohë paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte 70.083 lekë, me një rritje 2,3% krahasuar me një vit më parë.

Paga minimale u rrit në 34.000 lekë.

Shënim: Të dhënat janë mesatare të shifrave tremujoreve publikuar nga INSTAT

KOSTO E PUNËS PËR VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Pagat mesatare për një të punësuar në Ballkanin Perëndimor (EURO)




Paga mesatare bruto më e lartë në rajon është regjistruar në Malin e Zi, e ndjekur nga Serbia dhe Bosnjë dhe Hercegovina, ndërkohë Shqipëria vazhdon të ketë pagën mesatare më të ulët në rajon.


Burimi: Zyrat statistikore të vendeve

INVESTIMET NË SHQIPËRI

Investimet e Huaja Direkte, në % PBB




IHD stoku si % ndaj PBB



Flukset e Investimeve të Huaja në Shqipëri ruajtën të njëjtin trend edhe përgjatë vitit 2021, 7,2% të PBB, ndërsa stoku IHD arriti në 65,5% të PBB.

INVESTIMET NË SHQIPËRI

Investimet Publike, Formimi Bruto i Kapitalit Fiks and IHD




Burimi: INSTAT, BoA, MFE Mars 2023

Formimi bruto i kapitalit fiks arriti 24% gjatë vitit 2021.


Investimet publike arritën 6,8% të PBB, kurse Investimet e Huaja Direkte 7,2% të PBB.

INVESTIMET PRIVATE NË EKONOMI

Investime, në miliardë lekë



Investimet totale të ndërmarrjeve, % ndaj totalit




Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, gjatë 2021, investimet private ranë me 10,2%, dhe 53% e Investimeve vijnë nga prodhuesit e shërbimeve, në dallim nga një vit më parë. Shumica e Investimeve gjatë vitit 2021, kanë qenë investime në Makineri dhe Pajisje, 30% e totalit, në rënie krahasuar me një vit më parë prej 4,5p.p.


Burimi: INSTAT Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2021

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Fluksi hyrës IHD, milion Euro



Stoku IHD, milion EURO




Gjatë vitit 2022, fluksi hyrës i IHD u rrit me 16.5% krahasuar me një vit më parë. Edhe pse flukset hyrëse të IHD kanë qenë mjaft të ndryshueshme sipas cikleve të biznesit, që nga 2015 stoku i IHD në Shqipëri ka ruajtur një trend rritës deri në TIV 2019 dhe ka filluar sërish rimëkëmbjen gjatë TII 2020. Gjatë vitit 2022, flukset e IHD arritën 1,372 mln Euro, 53% e të cilave janë fitimet e riinvestuara të cilat kanë pësuar rritje duke filluar nga viti 2017.


Ndërkohë, gjatë vitit 2022, stoku i IHD u rrit me 18,8% krahasuar me një vit më parë duke arritur 11.339 milionë Euro.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Fluksi IHD sipas vendit të origjinës, në mln EURO



Stoku IHD, sipas vendit të origjinës, në milionë Euro




Hollanda është vendi me fluksin më të lartë të IHD-ve për vitin 2022, **219 milionë Euro** e ndjekur nga Italia me **136 milionë Euro** dhe Gjermania me **91 milionë Euro**.

Ndërkohë, Zvicra vazhdon të udhëheqë stokun e IHD-ve në vend edhe për vitin 2022, duke arritur në **1.891 milionë Euro** edhe pse me ritëm rënës të flukseve duke filluar nga viti 2016.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Fluksi IHD sipas aktivitetit ekonomik, në milionë Euro




Gjatë vitit 2022, sektori më tërheqës për IHD-të është Pasuritë e paluajtshme e ndjekur nga Industria nxjerrëse dhe energjia elektrike, gazi dhe furnizimi me ujë (me një rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë).

- Aktivite të pasurive të paluajtshme
- Industria nxjerrëse
- Energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë
- Aktivite financiare dhe të sigurimit
- Industria përpunuese
- Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorcikletave
- Informacioni dhe komunikacioni

FLUKSI I IHD NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Fluksi IHD Ballkani Perëndimor, % PBB




Shqipëria renditet e treta në rajon për IHD me 6,7% të PBB në 2021, duke ulur renditjen e saj krahasuar me një vit më parë.

Mal i Zi udhëheq rajonin përsa i përket flukseve hyrëse të IHD të cilat në 2021 ishin sa 11,8% e PBB e ndjekur nga Serbia me 7,2% e PBB për vitin 2021.

— ALB
— BIH
— XKX
— MKD
— SRB
— MNE

FLUKSI I IHD NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Fluksi IHD Ballkani Perëndimor, milionë USD



Flukset hyrëse të IHD në Serbi ishin 4,6 miliardë USD për vitin 2021, ndërsa në Shqipëri ato kapën shifrën e 1,2 miliardë USD

Vendi me më pak flukse hyrëse të IHD në rajon për vitin 2021 është Bosnja Hercegovina me 638 milion USD.

— ALB
— BIH
— XKX
— MKD
— SRB
— MNE

STOKU DHE PROFILI I NDËRMARRJEVE

TREGUESIT	NUMRI I NDËRMARRJEVE					
Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Ndërmarrjet Mikro (1-9 të punësuar)	102,965	101,595	100,876	96,924	95,558	97,022
Ndërmarrjet e Vogla (10-49 të punësuar)	4,413	4,839	5,246	5,736	5,674	5,608
Ndërmarrjet e Mesme (50-249 të punësuar)	996	1,077	1,147	1,251	1,173	1,227
NVM (1-249 të punësuar)	108,373	107,511	107,269	103,911	102,405	103,857
Ndërmarrjet e Mëdha (250+ të punësuar)	152	166	181	179	169	174
Gjithsej	108,526	107,677	107,450	104,090	102,574	104,031


TREGUESIT	NUMRI I NDËRMARRJEVE					
Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Ndërmarrjet Mikro (1-9 të punësuar)	194,015	192,817	194,867	196,403	186,400	191,250
Ndërmarrjet e Vogla (10-49 të punësuar)	87,796	95,574	102,950	114,451	111,347	111,318
Ndërmarrjet e Mesme (50-249 të punësuar)	98,491	107,171	113,911	122,330	114,767	121,002
NVM (1-249 të punësuar)	380,302	395,563	411,727	433,184	412,514	423,570
Ndërmarrjet e Mëdha (250+ të punësuar)	89,363	97,350	103,979	97,669	91,472	95,669
Gjithsej	469,665	492,913	515,706	530,853	503,986	519,240

Struktura e ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare dominohet nga ndërmarrje të vogla me 1-9 të punësuar

Stoku dhe Profili i Ndërmarrjeve, nuk përfshin aktivitetet e bujqësisë, peshkimit, aktivitetet e ndërmjetësimit monetar dhe financiar, administrata publike dhe e mbrojtjes si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare

INDEKSI I PERCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT

Indeksi i Perceptimit të korrupsionit, renditja 180 vende




Shqipëria renditet e 101/180 në rang botëror, duke përmirësuar pozicionin e saj nga viti i kaluar. Shqipëria e ka rritur vlerësimin e indeksit nga nga 35 një vit më parë, në 36 për vitin 2022.

Mal i Zi ka renditjen më të mirë nga të gjitha gjashtë vendet ne rajonin e Ballkanit Perëndimor (65/180).

LIRIA EKONOMIKE

Liria Ekonomike, 177 vende të vlerësuara



Burimi: www.heritage.com


Shqipëria renditet e 49a në rang botëror, duke përmirësuar pozicionin e saj nga viti i kaluar; Në rang rajonal, Shqipëria renditet e 27a nga 44 vende europiane

Vendi qëndron poshtë mesatares europiane (68,2) por është mbi mesataren botërore (59,3)

Shqipëria vlerësohet Relativisht e Lirë


TREGUESIT E LIRISË EKONOMIKE - INDEKSI NË VITE

Sundimi i Ligjit, Indeksi



Sundimi i ligjit vlerësohet i dobët në Shqipëri. E drejta mbi pronën vlerësohet mbi mesatare botërore; Efektiviteti juridik është mbi mesataren botërore; ndërsa integriteti i qeverisjes vlerësohet nën mesataren botërore.


Efektiviteti Rregullator, Indeksi



Efektiviteti rregullator ndikon në zbatimin e kontratave. Mundësitë e biznesit janë relativisht të shumta në energjia, turizmi, shëndetësia, bujqësia, TIK, etj. Rregullat e punës janë të qarta, por zbatimi është i pabarabartë.

TREGUESIT E LIRISË EKONOMIKE - INDEKSI NË VITE


Madhësia e Qeverisë, Indeksi



Sipas Madhësisë së Qeverisë, gjatë vlerësimit të vitit 2023 nuk ka ndryshim të madh në Indeksin e Barrës Tatimore, ndërkohë që ka përkeqësim të Indeksit për Shëndetin Fiskal, dhe Indeksin e Shpenzimeve Qeveritare.

Burimi: www.heritage.com


Liria e të bërit biznes, Indeksi



Përsa i përket Lirisë së Tregut, nuk ka ndryshim në Indeksin e Lirisë së Investimeve dhe Lirisë Financiare, ndërsa Indeksi i Lirisë së Tregut ka pësuar një rritje të lehtë.

INDEKSI GLOBAL I INOVACIONIT - RENDITJA NË NIVEL GLOBAL

Madhësia e Qeverisë, Indeksi




	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
SRB	70	65	58	56	57	53	54	55
MNE	40	46	52	55	45	49	50	60
ALB	112	71	115	83	70	83	84	84
MKD	55	62	63	84	59	57	59	66
BIH	122	104	86	68	71	74	75	70

Shqipëria renditet e 84-ta në Indeksin Global të Inovacionit për vitin 2022, e fundit në rajon; Serbia kryeson rajonin në Inovacion sipas raportit të fundit të GII, duke kaluar Malin e Zi.

INDEKSI GLOBAL I INOVACIONIT - RENDITJA 2022

Indeksi Global i Inovacionit, Renditja 132 ekonomi



Shqipëria renditet ulët në Kërkim dhe Kapital Njerëzor, Infrastrukturë, Sofistikim i Tregut dhe Njohuri dhe Prodhim Teknologjik

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula


Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbatjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council

 ALInvestCouncil

 Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).